3-YEAR-OLD KINDER
Best Start
Best Life

# Kopshti i fëmijëve tre vjecar

Për të patur ëndrra të mëdha, fëmijët tanë duhet të kenë një fillim të mbarë në jetë.



**Qeveria Viktoriane po investon pothuajse 5 (pesë) miliardë dollarë gjatë dekadës për të prezantuar kopshtin trevjeçar universal të financuar - dhe tashmë ky shërbim është në dispozicion në të gjithë shtetin.**

**Kjo do të thotë një vit tjetër i të mësuarit, rritjes, lojës dhe miqësimit për fëmijët viktorianë**

Pjesëmarrja në një program cilësor të kopshtit nga mosha tre vjeçare rrit rezultatet e të mësuarit zhvillimit, shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve.

### Fëmijët e vegjël mësojnë për botën përreth tyre përmes lojës

Të mësuarit në bazë të lojës është mënyra se si fëmijët e vegjël mësojnë më mirë. Ai u jep fëmijëve mundësinë të përdorin imagjinatën e tyre, të ndërtojnë aftësitë e tyre gjuhësore dhe të mësojnë rreth numrave dhe modeleve. Ata gjithashtu mësojnë se si të merren vesh me të tjerët, të ndajnë lodrat, të dëgjojnë dhe të menaxhojnë emocionet e tyre.

### Fëmijët në Viktoria kanë mundësi të shkojnë në kopsht për dy vjet

Fëmijët në të gjithë shtetin do të përfitojnë të paktën pesë orë programi kopshtesh të financuar çdo javë që nga viti 2022. Orët e përfitimit do të rriten deri në 15 (pesëmbëdhjetë) orë në javë deri në vitin 2029.

### Pavarësisht se në cilin kopsht shkon fëmija juaj, programet do të drejtohen nga mësues dhe edukatorë të trajnuar.

Fëmijët mund të ndjekin programin e kopshtit në shërbimet e çerdhes (childcare) ose të kopshtit të pavarur.

| |
|---|
| Fëmijët e vegjël **mësojnë për botën përmes lojës** |
| Ata mësojnë se si **të merren vesh me të tjerët, të ndajnë, të dëgjojnë dhe të menaxhojnë emocionet e tyre.** |
| Në një program kopshtesh, fëmijët përdorin lojën për të ndërtuar **aftësitë e tyre gjuhësore** dhe për të mësuar rreth **numrave dhe modeleve** |
| Mësuesit dhe edukatorët i ndihmojnë fëmijët të bëhen **kuriozë, krijues dhe të sigurt** për të mësuarin. |

## Programet e kopshteve ofrohen në mjedise të ndryshme

| | |
|---|---|
| **Kopshte të pavarura** | **Programet e kopshteve**<br>Fëmijët ndjekin programin e kopshtit për ditët dhe orët e përcaktuara |
| **Cerdhja (Long Day Care Service)** | **Programet e kopshteve**<br>Fëmijët ndjekin një program kopshtesh si pjesë e kohës së tyre në cerdhe |
| | **Edukimi dhe Kujdesi**<br>Sherbimet e cerdhes ofrojnë edukim dhe kujdes të fëmijërisë së hershme për fëmijët e moshës ndërmjet 0 (zero) dhe 6(gjashtë) vjeç |

Të gjitha programet e financuara të kopshteve duhet të përmbushin udhëzimet e qeverisë për sigurinë dhe cilësinë dhe janë zhvilluar në përputhje me Kornizën e Mësimit dhe Zhvillimit të fëmijërisë së hershme Viktoriane

Cerdhet ofrojnë ditë të plota të edukimit dhe kujdesit, duke përfshirë edhe ndjekjen e programit të kopshtit. Programi i kopshtit i drejtuar nga mësuesit është i integruar me orë shtesë të edukimit dhe kujdesit. Në shërbimet e kopshtit të pavarur, programi i kopështit do të funksionojë vetëm në ditë të caktuara dhe në kohë të caktuar. Këto ditë dhe orë përcaktohen nga shërbimi i kopshtit.

### Vendimi se ku ta dërgoni fëmijën tuaj mund të varet nga shërbimet që janë në dispozicion në komunitetin tuaj dhe cfarë është më e përshtatshme për familjen dhe fëmijën tuaj

### Regjistrimi i fëmijes në kopshtin universal trevjeçar të financuar

Flisni me shërbimin tuaj lokal të kopshtit rreth procesit të regjistrimit dhe afateve kohore, dhe vizitoni qendrën dhe stafin e tyre. Për të gjetur kopshtin tuaj lokal dhe për informacion se si të zgjidhni shërbimin e duhur për familjen tuaj, vizitoni: education.vic.gov.au/choose-kinder

Zgjedhja e një shërbimi cilësor të kopshtit do të sigurojë që fëmija të përfitojë maksimalisht nga koha e tij në kopsht. Ju mund të shikoni vlerësimet e cilësisë së shërbimit duke vizituar www.startingblocks.gov.au

### Koha e fillimit të kopshtit tre vjeçar të financuar

Shumica e shërbimeve kanë një proces regjistrimi që hapet një vit para se fëmija të fillojë programin e kopshtit, kështu që duhet të mendoni për regjistrimin kur fëmija juaj mbush dy vjeç.

Familjet dhe kujdestarët me fëmijë të lindur midis Janarit dhe Prillit mund të zgjedhin se në cilin vit fëmijet e tyre do të fillojne kopështin tre-vjeçar të financuar. Familjet mund të zgjedhin që fëmijët e tyre të marrin pjesë vitin e ardhshëm për t'u bashkuar me moshën e fillimit të shkollës, ndërsa fëmijët e tjerë do të jenë dy vjeç kur të fillojnë.

**Fëmijët e lindur midis 1 Janarit dhe 30 Prillit** kanë të drejtë të ndjekin kopshtin trevjeçar ose në vitin që mbushin tre ose në vitin që mbushin katër vjeç.

Fëmijët mund të mos jenë në gjendje të marrin pjesë derisa të mbushin tre vjet në programe ku shërbimi nuk është në gjendje të përmbushë raportin edukator ndaj fëmijëve të cilët janë dy vjeç.

**Fëmijët e lindur midis 1 Majit dhe 31 Dhjetorit** kanë të drejtë të ndjekin kopshtin trevjeçar vetëm në vitin që mbushin katër vjeç dhe kopshtin katër vjeçar në vitin që mbushin pesë vjeç.

## Moshat e fillimit të kopshteve

| Data e lindjes së fëmijës | Komente | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 Dhjetor 2016 - 30 Prill 2017 | Familjet mund të zgjedhin për të filluar shkollën Në vitin 2022 ose vitin 2023 | Kopshti i 3 vjecareve | Kopshti i 4 vjecareve | Viti përgatitor | Klasa e 1 | Klasa e 2 |
| | | | Kopshti i 3 vjecareve | Kopshti i 4 vjecareve | Viti përgatitor | Klasa e 1 |
| 1 Maj - 20 Dhjetor 2017 * | | | Kopshti i 3 vjecareve | Kopshti i 4 vjecareve | Viti përgatitor | Klasa e 1 |
| 21 Dhjetor 2017 - 30 Prill 2018 | Familjet mund të zgjedhin për të filluar shkollën në vitin 2023 ose vitin 2024 | | Kopshti i 3 vjecareve | Kopshti i 4 vjecareve | Viti përgatitor | Klasa e 1 |
| | | | | Kopshti i 3 vjecareve | Kopshti i 4 vjecareve | Viti përgatitor |
| 1 Maj - 20 Dhjetor 2018 * | | | | Kopshti i 3 vjecareve | Kopshti i 4 vjecareve | Viti përgatitor |

* Data e Dhjetorit është gjysëm simestri i katërt dhe i fundit në shkollën shtetërore Nëse duhet që shkolla e zgjedhur e familjes ka një ditë më të hershme të perfundimit te gjysëm simestrit të katërt, atëhere duhet përdorur ajo datë

## Kush mund të ndihmojë me pyetje të mëtejshme në lidhje me kopshtin tre vjeçar

- Shërbimi ose ofruesi juaj i kopshtit lokal, duke përfshirë edhe cerdhet
- Bashkia ose infermierja e shëndetit të nënës dhe fëmijës
- Merrni në telefon Departamentin e Shëndetësisë (Department of Health-DH) telefoni për prindërit në 13 22 89
- Dërgoni email 3yo.kindergarten@education.vic.gov.au

Vizitoni www.vic.gov.au/kinder

